



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 632/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.08.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit “Kërkesë për Propozime” me objekt “Blerje automjet për administratën (autoveturë fuoristradë)”, me fond limit 2,500,000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datë 25.05.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Finiq.

Ankimues: “Rafin Company” shpk
Rruga “Gjergj Kuçali” Pallati “C&S”, Kati 2, Zyra 4, Pranë ish Shushicës.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Finiq

Baza Ligjore: *Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.05.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit, “*Kërkesë për Propozime*” me objekt “*Blerje automjet për administratën (autoveturë fuoristradë)*”, me fond limit 2,500,000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datë 25.05.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Finiq.

II.2 Në datën 25.05.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 10.07.2017 autoriteti kontraktor ka vendosur anulimin e procedurës së prokurimit.

II.4. Në datën 13.07.2017 operatori ekonomik “*Rafin Company*” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimin e anulimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi me argumentat si më poshtë:

- *Më datë 10.07.2017 (një muaj pas hapjes së ofertave) jemi njoftuar nëpërmjet sistemit të APP për anulimin e procedurës së prokurimit me pretendimin se autoriteti kontraktor do të rishikojë specifikimet teknike. Si palë pjesmarrëse në procedurën e prokurimit të sipërpërmendur nuk jemi dakord me njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit pasi procedura e shqyrtimit dhe vlerësimi i ofertave është zhvilluar në*

shkelje të rëndë të Ligjit dhe Regullave të Prokurimit Publik si më poshtë vijon: Fillimisht dua tju sqaroj se më datë 23.06.2017 shoqëria jonë duke konstuar se KVO – ja në shkelje të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 dërgoi në SPE kërkesë lidhur me faktin se kur KVO-ja do të dërgonte njoftimin e kualifikim/skualifikimit. Më datë 27.06.2017 KVO –ja na ktheu përgjigje se i nevojitej kohë më tepër për shqyrtimin e ofertave dhe se do të na njoftonte në një moment të dytë. Lidhur me njoftimin e anulimit të procedurës ju njoftojmë se nuk jemi dakord pasi është bërë në shkelje të nenit 24 të LPP. Konkretisht arsyeja e anulimit e dhënë nga KVO-ja “Rishikim i specifikimeve teknike nuk është e bazuar në ligj pasi nuk përmbushet asnjë nga kushtet ligjore të nenit 24 të LPP. Për sa më sipër anulimi i procedurës është bërë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 24 të LPP. Për sa më sipër KVO duhet të rivlerësojë procedurën e prokurimit dhe të dërgojë njoftimin e kualifikim/skualifikimit.

II.5. Autoriteti kontraktor nuk i ka kthyer përgjigje ankimesit lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë.

II.6. Në datën 25.07.2017 ankimesi ka paraqitur ankesë me të njëjtin objekt pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr.2406 prot datë 23.08.2017 protokolluar me tonën me nr.1329/3 datë 25.08.2017 autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar duke argumentuar si më poshtë:

- *Duke ju referuar pozicionit të gjërë që ka kjo bashki duke përfshirë 3 ish komuna menduam që të rishikonim specifikimet teknike të mjetit duke i ofruar më shumë siguri stafit të bashkisë. Specifikimet teknike janë të lidhura me sigurinë e mjetit dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë lidhen me sigurinë e jetës së stafit të Bashkisë Finiq. Sipërfaqja e gjërë gjeografike që ka Bashkia Finiq, eksperiencia e viteve të kaluara me vatrat e zjarit që kanë rënë duke qenë bashkia më e reziuar në RSH, largësia e këtyre vatrave, natyra e thepisur menduam që të anulonim këtë procedurë me arsyetimin për rishikimin e specifikimeve teknike duke pasur parasysh interesin e publikut në radhë të parë ku në rastin tonë është siguria maksimale dhe mbrojtja nga reziqet e njerzve që përbëjnë gjithë organigramën e Bashkisë Finiq duke i ofruar këtyre të fundit siguri maksimale në ushtrimin e funksioneve të tyre. Udhëtimi me mjete jo të sigurta në juridiksionin e Bashkisë Finiq (shkak terreni, sipërfaqja e madhe dhe vatrat e zjarit) nuk ofron siguri maksimale në mbrojtjen e jetës të punonjësve të Bashkisë.*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese si dhe informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e ankimesit se “Më datë 10.07.2017 (një muaj pas hapjes së ofertave) jemi njoftuar nëpërmjet sistemit të APP për anulimin e procedurës së prokurimit me pretendimin se autoriteti kontraktor do të rishikojë specifikimet teknike. Si palë pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit të sipërpërmendur nuk jemi dakord me njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit pasi procedura e shqyrtimit dhe vlerësimi i ofertave është zhvilluar në shkelje të rëndë të Ligjit dhe Regullave të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 25.05.2017 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

III.1.2. Në datën 10.07.2017 autoriteti kontraktor ka vendosur anulimin e procedurës së prokurimit. Autoriteti kontraktor (referuar informacionit të drëzuar pranë KPP) ka argumentuar se Duke ju referuar pozicionit të gjërë që ka kjo bashki duke përfshirë 3 ish komuna menduam që të rishikonim specifikimet teknike të mjetit duke i ofruar më shumë siguri stafit të bashkisë. Specifikimet teknike janë të ldhura me sigurinë e mjetit dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë lidhen me sigurinë e jetës së stafit të Bashkisë Finiq. Sipërfaqja e gjërë gjeografike që ka Bashkia Finiq, eksperiencia e viteve të kaluara me vatrave e zjarrit që kanë rënë duke qenë bashkia më e rezikuar në RSH, largësia e këtyre vatrave, natyra e thepisur menduam që të anulonim këtë procedurë me arsyetimin për rishikimin e specifikimeve teknike duke pasur parasysh interesin e publikut në radhë të parë ku në rastin tonë është siguria maksimale dhe mbrojtja nga reziqet e njerzve që përbëjnë gjithë organigramën e Bashkisë Finiq duke i ofruar këtyre të fundit siguri maksimale në ushtrimin e funksioneve të tyre. Udhëtimi me mjete jo të sigurta në juridiksionin e Bashkisë Finiq (shkak terreni, sipërfaqja e madhe dhe vatrave e zjarrit) nuk ofron siguri maksimale në mbrojtjen e jetës të punonjësve të Bashkisë.

III.1.3. Në nenin 24, pika 1 “Anulimi i një procedure prokurimi” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm:

- a. Për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik;
- b. Nëse nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve ligjore;
- c. Kur në fazën e parë të procedurës së kufizuar dhe me negociim me shpallje paraprake të njoftimit kualifikohen më pak se 2 kandidatë;
- d. Nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit;
- e. Nëse të gjitha ofertat e pranuar përbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të parashikuar për një kontratë të caktuar;
- f. Kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji.”

III.1.4. Në nenin 60 të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nxjerrë në zbatim të ligjit të mësipërm, është parashikuar shprehimisht: *“Me miratimin e ligjit për buxhetin dhe pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:*

- *objektin e prokurimit;*
- *fondin e përlllogaritur të vitit ushtrimor si dhe fondin total të përlllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare;*
- *llojin e procedurës së prokurimit dhe arsyet e përdorimit të saj;*
- *emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit”.*

III.1.5. Referuar sa më sipër KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk ndodhet në kushtet e parashikuara në pikën 1, gërma “a” të dispozitës së sipërcituar, pasi *shkaqet e pretenduara varen nga autoriteti kontraktor dhe, mëse të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik.* Argumenti i autoritetit kontraktor se *duhet të ndryshohen specifikimet teknike për sigurinë e punonjësve*” është i paarsyetuar dhe si i tillë nuk qëndron, pasi autoriteti kontraktor ka pasur kohën e nevojshme për hartimin e specifikimeve teknike nga grupi i punës dhe nuk mund ta pretendojë këtë në këtë fazë të procedurës kur operatorët ekonomikë pjesmarrës janë investuar të marrin pjesë dhe të dorëzojnë ofertat e tyre në këtë procedurë.

Gjithashtu KPP sqaron se anulimi i procedurës së prokurimit dhe akoma më tej arkivimi i saj (pasi nuk gjendet në sistemin e prokurimeve elektronike) është kryer në kundërshtim të ligjit për prokurimin publik, pasi autoriteti kontraktor duhet të respektonte afatet e ankimimit prej 7 ditë në autoritetin kontraktor dhe më pas prej 10 ditë që ligji i njeh si të drejtë operatorit ekonomik ankimues për të ushtruar të drejtën e ankimimit pranë KPP-së. Në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, neni 63, pika 6, përcaktohet se: *“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.*

III.1.6. Përsa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor nuk ndodhet në asnjë prej rasteve të parashikuara në nenin 24/1 të LPP-së për anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se anulimi i procedurës së mësipërme të prokurimit, duke mos e argumentuar dhe justifikuar atë shkakton tejzgjatje të procedurës së prokurimit në kundërshtim me qëllimin dhe frymën e ligjit për të rritur efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale, të sigurojë një trajtim të

barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rafin Company” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me objekt “Blerje automjet për administratën (autoveturë fuoristradë)”, me fond limit 2,500,000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datë 25.05.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Finiq.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit dhe të kryejë veprimet e nevojshme për rikthimin në sistemin elektronik të prokurimeve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Rafin Company” sh.p.k..
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1329 Protokoli, Datë 25.07.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha